SistemAbitare
Agenzia Sociale

AMBITO DI DESIO

LAJMËRIM S.A.P.
NGA 27 SHKURT 2020 NË 02 PRILL 2020

Sipas Ligjit Rajonal n.16/2016

dhe Rregullores n.4/2017

Lajmërim për Shërbimin e Shtëpive Komunale

Në pritje të hapjes së lajmërimit duam të informojmë të gjithë të interesuarit mbi dokumentat e nevojshme dhe mënyrat e paraqitjes së kërkesës.

KUSH MUND TË PARAQESË KËRKESËN?

Mund të paraqesin kërkesën personat që posedojnë specifikat e parashikuara në ’art.7 të Rregullores rajonale 4/2017 e modifikuar dhe e integruar në mars 2019 dhe nga ligji rajonal i datës 8 korrik 2016 n.16.

Njësitë familjare me ISEE më të lartë se € 16.000, siç parashikohet nga art. n. 7 i rregullores së lartëpërmëndur, **nuk** mund të paraqesin kërkesë.

SI TA PARAQESESH KËRKESËN?

Kërkesa duhet të plotësohet nga kërkuesi ekskluzivisht në mënyrë telematike nëpërmjet platformës SIAGE:

https://www.serviziabitativi.servizirl.it/serviziabitativi/

Për të hyrë në platformë kërkohet posedimi i **teserës CRS (Karta Rajonale e Shërbimeve)** e vlefshme ose **CNS (Karta Nacionale e Shërbimeve)** me PIN, që mund të kërkohet në Sportelin URP të komunës së banimit për qytetarët e komunave të Desio, Cesano Maderno e Muggio’ ose në A.S.S.T. territorjal; ose të **kredencialeve SPID** (Sistemi Publik i Identitetit Dixhital), **<u>të aktivizuara dhe të verifikuara</u>**.

Janë të disponueshme “stacione” telematike në zyrat e Komunave të Zonës dhe të Aler. Lista e “stacioneve” është e konsultueshme në lajmerimin publik. Kërkesat duhet të plotësohen direkt nga qytetari.

CILAT DOKUMENTA JANË TË NEVOJSHEME PËR PARAQITJEN E KËRKESËS?

- **tesera CRS** (Karta Rajonale e Shërbimeve) e vlefshme ose **CNS** (Karta Nacionale e Shërbimeve) me **PIN**, e cila mund të kërkohet te A.S.S.T. territorial; ose **kredencialet SPID** (Sistemi Publik i Identitetit Dixhital) **<u>të aktivizuara dhe të verifikuara</u>**;

- të dhënat personale dhe **kodet fiskale** të të gjithë pjestarëve të njësisë familjare;

- data e rregistrimit në zyrën e gjendjes civile komunale dhe rajonale,

- kopja e stampuar e **ISEE** e vlefshme;

- pullë takse (*marca da bollo*) prej € 16,00 ose kartë krediti për pagesën "on line";

- adresë e **postës elektronike** dhe **celular** që të mund të përdoren gjatë proçesit te regjistrimit.

Ju kujtojmë se kërkesa mund të plotësohet "on line" edhe në mënyre **autonome** dhe se edhe në rast ndihme pranë "stacioneve" telematike të vëna në dispozicion, **përgjegjësia për deklaratat e dhëna është gjithësesi gjithmonë personale.**

Me publikimin e lajmërimit do të bëhen të ditura "stacionet" telematike të vëna në dispozicion nga Komunat dhe Aler. Ndër të tjera do të organizohen nga ASC Konsorciumi "Desio-Brianza" klasa për të mësuar dhe lehtësuar qytetarin për plotësimin e kërkesës.

Rajoni i Lombardi-se ka aktivizuar një numër pa pagesë për ndihmën e përdoruesit:

800.131.151

Per informacione drejtohuni te sporteli **SistemAbitare**
çdo te mërkurë nga ora 9.30 deri në orën 12.30

Pranë A.S.C Consorciumi Desio-Brianza
Viale Lombardia 59, Desio
036239171
agenziabitare@codebri.mb.it